



VENDIM

Nr.16 Datë 11.02.2015

PËR

FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “ GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBER ” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të neneve 3 pika 31; 8 pika 2 , gërma “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4, dhe 48 pika 2 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neni 4, pika 1, gërma “P”; 5 pika 1 germa “P”; dhe 8, neni 10 pika 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, neni 18 pika 1 gërma “a” të “ Rregullave e Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s ” me vendim nr 21 datë 18.03.2009, i ndryshuar. Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.02.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “GAEA- ENERGJIA E ENERGJISË ELEKTRIKE” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “ **GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBËR** ” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1
Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 2
Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni finaciar dhe fiskal është i plotësuar në gjuhën Greke. Sipas nenit 8 pika 3 dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën Shqipe.

Dokumentacioni teknik:

- Neni 9, pika 4/9, gërma a e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/9, gërma b i pa plotësuar.
- Neni 9, pika 4/9, gërma c e plotësuar.

- Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të “*Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plote/te Pjesshem dhe Rinovimit të Licensave*”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ **GAEA-ENERGJIA ALTERNATIVE E GJELBËR** ” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të Energjisë Elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI